



5180
18.12.2002

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 665 , datë 18.12.2002

P Ë R

MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS, NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE "LOCKHEED MARTIN
GLOBAL INC." PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË
TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 7877, datë 30.11.1994, "Për aviacionin civil shqiptar", të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, "Për prokurimin publik" dhe në vijim të vendimit nr.541, datë 31.10.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e studimit të fizibilitetit të shërbimit të trafikut ajror shqiptar, përgatitur nga shoqëria ndërkombëtare "Lockheed Martin Global Inc.", me propozimin e ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektkontratës, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil) me shoqërinë ndërkombëtare "Lockheed Martin Global Inc.", për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror, me vlerë 32 977 807 (tridhjetedy milionë e nëntëqindeshtatëdhjeteshtatë mijë e tetëqindeshtatë) USD.

2. Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, sha., që për fondin e vet prej 3 295 000 (tre milionë e dyqindënëntëdhjetepesë mijë) USD, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" me shoqërinë ndërkombëtare "Lockheed Martin Global Inc.", për zbatimin e fazës së parë të projektit, sipas projektkontratës të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Vlefshmëria e kontratës për zbatimin e fazës së dytë të projektit është lidhur dhe do të zbatohet në përputhje me sigurimin e burimeve përkatëse të financimit dhe me hyrjen në fuqi të marrëveshjes për këtë qëllim.
4. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, dhe Ministria e Ekonomisë, nëpërmjet Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, sha, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe nga kontrata.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

FATOS NANO


NË MUNGESË DHE ME POROSI

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTËR
I PUNËVE TË JASHTME**


ILIR META

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE I TELEKOMUNIKACIONIT**

SPARTAK POÇI



NR.PROT.4514
DATË 26.12.2002

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË
TELEKOMUNIKACIONIT
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCEVE
MINISTRISË SË EKONOMISË
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

YLLI MANJANI



Republic of Albania
Council of Ministers

DECISION

No 665, date 18.12.2002

FOR THE APPROVAL OF THE PROJECT-CONTRACT,
BETWEEN THE GOVERNMENT OF REPUBLIC OF ALBANIA
AND "LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC." FOR THE
MODERNIZATION OF THE ALBANIAN AIR TRAFFIC
SERVICE.

Upon article 100 of the Constitution, article 7, law No.7877, date 30.11.1994 "For Albanian Civil Aviation" of article !7, Section 3 , Law No. 7971, on date 26.07.1995" For Public Procurement and in pursuance to the decision no. 541, date 31.10.2002, of the council of the ministers , " For the approval of the feasibility study of the Albanian air traffic service , prepared from the International Company" LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC" with proposal of the minister of Transports and telecommunication, s Council of the Ministers.

DECIDED:

The approval of the Project Contract between the government of Republic of Albania represented from the ministry of the transport and telecommunication (DIRECTORATE GENERAL OF CIVIL AVIATION (DGCA) and International Company "LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC." for the modernization of the air traffic, with amount 32977807(thirty two million nine seventy seven thousand eight hundred and seven) USD.

The authorization of NATIONAL AIR TRAFFIC AGENCY (NATA)

, with its fund of 3 295 000 (three million and two hundred and ninety five thousand) USD, to use the procedure "Direct Procurement" with the international company "Lockheed Martin Global Inc", for the implementation of the first phase of the project, based on the project-contract mentioned above in section 1 of this decision.

The contract for the implementation of the second phase of the project has been signed and will be implemented in accordance with the procurement of proper financial means and with the entrance into force of the agreement for this purpose.

The Ministry of Transport and Telecommunications, through the General Directory of Civil Aviation, and the Ministry of Economy, through NATIONAL AIR TRAFFIC AGENCY (NATA), for the implementation of the obligations that derive from this decision and from the contract.

This decision enters into force immediately and is published in the "Official Bulletin"

PRIME MINISTER

FATOS NANO

IN ABSENCE AND RECOMMANDATION

**DEPUTY PRIME MINISTER AND MINISTER
OF FOREIGN AFFAIRS**

ILIR META

MINISTER OF TRANSPORT
AND TELECOMMUNICATION

SPARTAK POCI